

GREQISHTJA - BIJË E SHQIPES

Agron DALIPAJ*

PËRMBLEDHJE

A mund të jetë greqishtja, kjo gjuhë e ndritur e qytetërimit europian, bijë e një gjuhe tjetër që zyrtarisht u bë me alfabet vetëm 111 vite më parë! Ndër kaq, nuk e kemi zor të pranojmë se kostumi elegant i presidentit të USA mund të jetë stiluar nga një emigrant moldav. Paralelja logjike duket absurde. Po të isha i pari njeri që e thosha se greqishtja është bijë e shqipes, do ti justifikoja të gjithë ata që do më kategorizonin si të shkalamendur. Porse e kam më se seriozisht se shqipja ka stilizuar që në krye të herës greqishten dhe jo vetëm atë. Gjithë glosologët europianë, e më tej, kanë pranuar pa mdyshe hegjemoninë e gjuhës greke mbi gjithë gjuhët europiane e më gjerë. Kaq e aq koncepte gjuhësore greke përdoren në shkallë botërore në mjekësi, fizikë, kimi, filozofi e në shumë shkenca të tjera. Përqsja ndaj së vërtetës është gjithmonë me rrezikun e të panjohurës brenda. Nëse në eksperimentet kimike apo fizike një gabim mund të marri jetën e specialistit apo shkencëtarit, në lëmin e shkencës së etimologjisë gabimi e pakujdesja të nxijnë emrin për tërë jetën dhe aq më zi kur gabuesi është "emër i madh" në shkencë. Në lashtësi askush nuk dinte se ngase shkakttoheshin sëmundjet dhe pse përhapeshin ato. Por një lente e thjeshtë e mikroskopit i parapriu revolucionit më të madh në mjekësi. Nëse mikroskopi i lejoi njerut të njohë botën e madhe e të panjohur të mikrogjallesave, prej të cilave varet në masën më të madhe cikli i jetës në tokë, por ai, njeriu modern, nuk ka qenë në gjendje deri sot të zbërthejë fjalën e të kuptojë se si është krijuar ajo. Dhe bëhet fjalë fiks për këtë njeri që bëri mrekullinë duke zbërthyer atomin. Më afër së vërtetës janë afruar "etimologët popullorë shqiptarë", por fakti se ata nuk mbështeten mbi parime të sakta shkencore duke i mëshuar fort empirizmit dhe gjetjeve dukshëm të thjeshta, ngecen në baltovinën e padijes për zbërthimin e korpusit më të madh të leksikut dhe herë herë bëhen qesharkë me "zgjidhjet" e tyre që nuk janë zgjidhje. Aq shumë ngjajnë ata me xherahët e epokës së Perandorisë Turke. "Lentja e suksesit" në etimologji është teoria shkencore e embriomorfeve e cila nëpërmjet parimeve e rregullave të përcaktuara qartë arrin ta zbërthejë fjalën në kuptimet më të vogla të mundshme dhe të precizojë se çdo bashkëtingëllore brenda një fjale përfaqëson një kuptim potencial real dhe e përkufizon fjalën si bashkësi embriomorfemash që kapen mes tyre për të krijuar një koncept gjuhësor që rëndom e quajmë fjalë. Ende sot jemi në kërkim për të gjetur një institucion zyrtar shkencor për të afirmuar këtë teori të re me të cilën synojmë të sjellim revolucionin më të madh në gjuhësinë botërore. Porse kërkesës sonë ASH-ja e Tiranës iu përgjigj se "akademikët e saj nuk kanë kohë të përshtatshme për tu marrë me këtë teori". Gjithsesi, ata e kanë kuptuar se kjo teori nxjerr fallco krejt morfologjinë e sotme zyrtare të gjuhës shqipe dhe të të gjitha gjuhëve i.e. dhe në vend të saj zë vend tabela e embriomorfemave e cila nuk ka më shumë se sa 400 elementë gjuhësorë kuptimorë dhe të cilët kanë formuar gjithë leksikun e gjuhëve i.e. dhe janë në gjendje të zbërthejnë cdo fjalë duke na lejuar të kuptojmë etimologjinë e saktë të tyre. E rëndësishme është të theksojmë se këto embriomorfe, që përbëjnë tabelën e plotë të tyre, gjenden të gjitha të lira vetëm në gjuhën shqipe dhe në asnjë tjetër. Mjafton të theksojmë se greqishtja ka vetëm 11 embriomorfe të lira që sillen si plagjiatura të shqipes dhe me aq pak e ka të pamundur të mbërthejë koncepte, fjalë. E njëjta gjendje, si në greqisht, është edhe në gjuhët e tjera. Kjo teori, me tabelën e saj të embriomorfeve, sjell shqipen si qendër e gjuhëve i.e. në mënyrën më të pakundërshtueshme shkencërisht. Nëse ASH-ja e Tiranës nuk do ishte një institucion gjytyrimesh që vetëm sa mëtojnë përrallat sllave, me kohë gjërat do kishin përparuar. Kam rastin t'ju bëj me dije që së shpejti do paraqes librin "GREQISHTJA - BIJË E SHQIPES" ku me anë të teorisë së embriomorfeve vërtetojmë se i gjithë fjalori bazë i greqishtes është produkt i shqipes. Sigurisht edhe për këtë libër do kërkojmë zyrtarisht oponencë shkencore nga Akademia e Shkencave dhe nga Akademia e Studimeve Albanologjike në Tiranë.